



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV/PROTOKOLLIT

Tiranë, më 24.10. 2022

Lënda : Njoftim për shpallje konkursi për 1 (një) vëndi të lirë pune për personel akademik, “Asistent-Lektor”, në Departamentin e Rehabilitimit, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit.

DREJTORISË SË ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE DHE DIXHITALIZIMIT TË
SHËRBIMEVE AKADEMIKO-SHKENCORE
KËTU

Universiteti i Sporteve të Tiranës, bazuar në Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UST-së, si dhe në vendimin e Rektorit të UST-së, shpall kriteret për punësimin e 1 (një) vëndi të lirë pune për personel akademik, “Asistent-Lektor” pranë Departamentit të Rehabilitimit, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit.

- I. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për pozicionin e punës si **“Asistent - Lektor”** me kohë të plotë në lëndën: **“Rehabilitim Ushtrimor Specifik”**, si më poshtë;

Kritere të përgjithshme:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
2. Të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njëhësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
3. Kandidati duhet të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8.
4. Kandidati duhet të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).
5. Kandidati të përmbushë kriteret që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
6. Kandidati të mos ketë prishur ose dëmtuar imazhin e UST-së.
7. Kandidati të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Kritere specifike :

1. Të ketë mbaruar studimet e larta universitare për Fizioterapi me notën mesatare mbi 8 (tetë).

2. Të ketë notë mesatare mbi 8 (tetë) në studimet të nivelit të dytë “Master Shkencor”.
3. Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime, botime brënda dhe jashtë vendit.
4. Të ketë 2(dy) referenca nga profesorë të fushës.
5. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në IAL.
6. Të ketë eksperiencë në praktika klinike.
7. Të ketë kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar.

Kritere preferenciale:

1. Kanë preferencë kandidatët që kanë kryer kualifikime kombëtare dhe ndërkombëtare që i përkasin fushës së lëndës.
2. Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime, botime brënda dhe jashtë vendit të lidhura me fushën e kërkuar.

Vlerësimi i Intervistës:

- Në aftësitë shprehëse për mënyrën e paraqitjes së filozofisë së mësimdhënies nga ana e kandidatit.
- Prezantimin në ppt dhe referimin e një teme që lidhet me fushën, specialitetin, lëndën që ai pretendon të mbulojë (mini – leksion).
- Të jetë i gatshëm t’i përgjigjet pyetjeve të ndryshme rreth fushës së studimit.
- Kandidati duhet të jetë i përgatitur që mund të intervistohet edhe në gjuhën të cilën ai ka të certifikuar në aplikim.
- Vlerësimi i Kandidatit në Total është me 100 pikë, 30 pikë nga Intervista dhe 70 pikë nga kriteret e përcaktuara.

Vlerësimi i Intervistës:

- Në aftësitë shprehëse për mënyrën e paraqitjes së filozofisë së mësimdhënies nga ana e kandidatit.
- Prezantimin në ppt dhe referimin e një teme që lidhet me fushën, specialitetin, lëndën që ai pretendon të mbulojë (mini – leksion).
- Të jetë i gatshëm t’i përgjigjet pyetjeve të ndryshme rreth fushës së studimit.
- Kandidati duhet të jetë i përgatitur që mund të intervistohet edhe në gjuhën të cilën ai ka të certifikuar në aplikim.
- Vlerësimi i Kandidatit në Total është me 100 pikë, 30 pikë nga Intervista dhe 70 pikë nga kriteret e përcaktuara.

II. Kandidatët që do të aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

- a) Mbushja e aplikimit (formulari tip) dhe firmosja e tij në cdo faqe, të cilën e shkarkoni nga web-siti i UST-së.
- b) Shprehje e interesit nga ana e kandidatit me shkrim për plotësimin e vendit vakant duke shprehur në të edhe vizionin e tij për këtë pozicion.
- c) Biografi e punës mundësisht me eksperiencat që lidhen me vendin e punës për të cilin aplikon kandidati.
- d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).

- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar, sipas plotësimit të kriterëve të shpallura.
- f) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) ose formulari i vetëdeklarimit.
- g) Letra rekomandimi nga profesorë të fushës.
- h) Fotokopje të dëshmive të kualifikimeve të ndryshme, të noterizuara.
- i) Listë të punimeve shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare profesionale/shkencore dhe/ose punime të tjera, pjesëmarrje në referime shkencore, në konferenca etj; (mundësisht linku i artikullit ose conferences. ISBN ose ISSN të artikujve ose botimeve).

III. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik dhe në faqen e UST-së, mund të dorëzohet on-line në e-mailin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit (lshehu@ust.edu.al) ose me postë sipas afateve të shpallura:

- Në rastin e aplikimit online në faqen zyrtare të UST-së, kandidati është i detyruar që të dorëzojë edhe fizikisht dosjen e tij të aplikimit ditën që do të ftohet për intervistë nëse kalon fazën e parë të aplikimit.
- Kandidati nuk mund të paraqesë asnjë dokument tjetër shtesë përvec atyre që ka aplikuar on-line në web-site të UST-së, (në e-mailin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit)
- Dokumentacioni i dorëzuar me anë të shërbimit postar dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të këtyre kandidatëve.

IV . Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 10 (dhjetë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit në faqen e UST-së dhe APP.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit dhe departamenti ku konkuron.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE ARKIV/PROTOKOLLIT